**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
**KOMUNA E JUNIKUT**
MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNI

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/128;**
**Datë: 31.03.2017 .**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
Komuna Junik-Opština Junik

| 02/Nr.Port. | Nr.i faq | Data |
|---|---|---|
| 2-180/8645 | 2 | 04.04.2017 |

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 21 paragrafi 21.1 pika k) të Statutit të Komunës së Junikut; dhe nenit 16 paragrafi 3. të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 31.03.2017, nxjerrë:

# VENDIM

për fillimin e hartimit të

(projekt) **Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2018**

**I.** Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) **Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2018** /në tekstin e mëtejmë (projekt) Rregullorja/.

**II.** Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) Rregulloreje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2018.

**III.** Bartëse e hartimit të (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi është Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

**IV.** Bartësja e hartimit të (projekt) Rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartojë në afat prej 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

**V.** Autorizohet kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi.

**VI.** (Projekt) Rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.

**VII.** Pas hartimit, (projekt) Rregullorja i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

**VIII.** Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.

**IX.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

**X.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

**XI.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj ____________

kryesues

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/129;**
**Datë: 31.03.2017 .**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
Komuna Junik-Opština Junik

| 02/Nr.Port. | Nr.i faq | Data |
| --- | --- | --- |
| 2-180/2644 | 2 | 04.04.2017 |

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 21 paragrafi 21.1 pika k) të Statutit të Komunës së Junikut; dhe nenit 16 paragrafi 3. të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 31.03.2017, nxjerrë:

# VENDIM

për fillimin e hartimit të

(projekt) **Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale**

**I**. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) **Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale** /në tekstin e mëtejmë (projekt) Rregullorja/.

**II.** Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) Rregulloreje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

**III.** Bartëse e hartimit të (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi është Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

**IV.** Bartësja e hartimit të (projekt) Rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartojë në afat prej 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

**V.** Autorizohet kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi.

**VI.** (Projekt) Rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.

**VII.** Pas hartimit, (projekt) Rregullorja i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

**VIII.** Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.

**IX.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

**X.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

**XI.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Ministria për Buxhet dhe Financa;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj ______________

kryesues

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/130;**
**Datë: 31.03.2017 .**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
Komuna Junik-Opština Junik

| 02/Nr.Port. | Nr.i faq | Data |
|---|---|---|
| 2-180/2637 | 2 | 04.04.2017 |

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 21 paragrafi 21.1 pika k) të Statutit të Komunës së Junikut; dhe nenit 16 paragrafi 3. të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 31.03.2017, nxjerrë:

# VENDIM

për fillimin e hartimit të
(projekt) **Rregullores për shpërndarjen e subvencioneve**

**I.** Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) **Rregullores për shpërndarjen e subvencioneve** /në tekstin e mëtejmë (projekt) Rregullorja/.

**II.** Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) Rregulloreje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për shpërndarjen e subvencioneve komunale.

**III.** Bartëse e hartimit të (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi është Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

**IV.** Bartësja e hartimit të (projekt) Rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartojë në afat prej 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

**V.** Autorizohet kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e (projekt) Rregullores nga pika I. e këtij vendimi.

**VI.** (Projekt) Rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.

**VII.** Pas hartimit, (projekt) Rregullorja i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

**VIII.** Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.

**IX.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

**X.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

**XI.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Ministria për Buxhet dhe Financa;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj, ___________

kryesues

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT
MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
Komuna Junik-Opština Junik

| 02/Nr.Port. | Nr.i faq | Data |
|---|---|---|
| 2-180/2566 | 2 | 03.04.2017 |

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/131;**
**Datë: 31.03.2017 .**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008) dhe nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.03.2017 nxjerrë:

# V E N D I M

**për**

**bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar për këtë vit**

**I.** Me këtë vendim miratohet propozimi i kryetarit të komunës së Junikut për bartjen e mjeteve financiare vetanake të pashpenzuara nga viti 2016 në vitin 2017 në vlerë prej **17.698,66** € si në vijim:

I.1. Shuma prej **13.727,63 €** bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale në kodin 44195 për projektin Bashkefinancim i projekteve në kodin ekonomik 31230 (ndërtimi i rrugëve lokale) në programin e zhvillimit ekonomik me kod 480 në nënprogramin planifikimi i zhvillimit ekonomik me kod 48020 (bashkëfinancim në projekte kapitale me DEMO-s, MDA).

I.2. Shuma prej **3.015,50 €** bartet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime në programin zyra e Kuvendit të Komunës me kod 169 në nënprogramin zyra e Kuvendit të Komunës me kod 16920 në kodin ekonomik 13460 (shërbimet tjera kontraktuese).

I.3. Shuma prej **295,00 €** bartet në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere në programin zyra e kryetarit me kod 160, në nënprogramin zyra e kryetarit me kod 16020 në kodin ekonomik 21110 (subvencione për entitete publike).

I.4. Shuma prej **660,53 €** bartet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime në programin shëndetësia dhe mirëqenia sociale me kod 730 në nënprogramin shërbimet e shëndetësisë primare me kod 74200 në kodin ekonomik 13630 (furnizime mjekësore).

**II.** Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në realizimin e të gjitha procedurave administrative lidhur me bartjen e mjeteve financiare nga pika I. e këtij vendimi.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

*Me këtë vendim njoftohen:*

1. MAPL;
2. Ministria e Financave;
3. Kryetari i Komunës së Junikut;
4. Shërbimi i kuvendit të komunës, dhe
5. Arkivi i komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ ____________

kryesues

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
**KOMUNA E JUNIKUT**
MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNI

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
Komuna Junik-Opština Junik
02/Nr.Port. 2-18/2636 | Nr.i faq 1 | Data 04.04.2017

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/132;**
**Datë: 31.03.2017 .**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 10 paragrafi 10.2 dhe paragrafi 10.3 të Ligjit për Tokën Bujqësore (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 13/2007) dhe nenit 8 paragrafi 8.4 të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore (U.A. Nr. 41/2006) dhe nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4. të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 31.03.2017, nxjerrë:

# VENDIM
## Paraprak
## Për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

I. Me këtë vendim ndërrohet destinimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

**II.** Parcelës kadastrale me numër P-73105038-04585-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej **7569 m²** zona kadastrale Junik me kulturë tokë bujqësore e klasës së 2-të në vendin e quajtur Gerlesha-Arave i ndërrohet destinimi i sipërfaqes prej **4933 m²** nga shfrytëzimi aktual si tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

**III.** Parcelës kadastrale me numër P-73105038-04583-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej **2904 m²** zona kadastrale Junik me kulturë tokë bujqësore e klasës së 3-të në vendin e quajtur Gerlesha-Arave i ndërrohet destinimi i sipërfaqes prej **1865 m²** nga shfrytëzimi aktual si tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

**IV.** Parcelat kadastrale nga pika II. dhe III. e këtij vendimi pas nxjerrjes së vendimit përfundimtar duhet të evidentohen si toka ndërtimore në Planin Zhvillimor Komunal.

**V.** Kompensimi për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas pikës I. të këtij vendimi do të paguhet në procedurë administrative me rastin e aplikimit për leje ndërtimi sipas kritereve të parapara me nenin 14 paragrafi 14.2 pika a) të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Destinmit të Tokës Bujqësore (U.A. Nr. 41/2006).

**VI.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

**VII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis e Komunës së Junikut.

**VIII.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj

kryesues

Adresa:
Tel.: +386 (0) 49 760 270
http://rks-gov.net/junik

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
**KOMUNA E JUNIKUT**
MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/133;**
**Datë: 31.03.2017 .**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
Komuna Junik-Opština Junik

| 02/Nr.Port. | Nr.i faq | Data |
|---|---|---|
| 2-180/2633 | 2 | 04.04.2017 |


Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe nenit 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 39 paragrafi 39.2 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 12 paragrafi 12.2 dhe paragrafi 12.3 të Rregullores për simbolet, titujt e nderit, dekoratat, medaljet, mirënjohjet dhe falënderimet në komunën e Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.03.2017 nxjerrë:

# VENDIM

## për themelimin dhe përbërjen e Komisionit Vlerësues për Ndarjen e Çmimit "Nderi i Junikut"

**I.** Me këtë vendim themelohet Komisioni Vlerësues për Ndarjen e Çmimit "Nderi i Junikut"/në tekstin e mëtejmë Komisioni/.

**II.** Komisioni nga pika I. e këtij vendimi do të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë.

**III.** Komisioni do të punojë në këtë përbërje:

1. Letrim Salihaj – anëtar, përfaqësues i KK-së;
2. Bleranda Gacaferi – anëtare, përfaqësuese e KK-së;
3. Hasan Krasniqi – anëtar, përfaqësues i ekzekutivit të komunës;
4. Leonita Jasiqi – anëtare, përfaqësuese e ekzekutivit të komunës; dhe
5. _____________ - anëtar/e, përfaqësues/e i/e shoqërisë civile.

**IV.** Mandati i anëtarëve nga pika I. e këtij vendimi përfundon me përfundimin e punës respektivisht me vlerësimin e propozimeve për ndarjen e çmimit "Nderi i Junikut".

**V.** Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me nenin 12 dhe 13 të Rregullores për simbolet, titujt e nderit, dekoratat, medaljet, mirënjohjet dhe falënderimet në komunën e Junikut.

**VI.** Komisioni për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës së Junikut.

**VII.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

**VIII.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

- Me këtë vendim njoftohen:
    1. MAPL;
    2. Kryetari i Komunës së Junikut;
    3. Anëtari nga pika III. e këtij vendimi;
    4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
    5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj ___________

kryesues